

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, gjyqtarët Fllanza Kadiu dhe Rasim Rasimi, anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Lirije Maksutaj, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit Z.F., nga fshati C Komuna e P., për shkak të veprave penale Vjedhje e rëndë parashikuar me nenin 253 par.1 nënparagrafi 2 të KPK-ës, duke vendosur përkitazi me ankesat e Prokurorit Publik Komunal në Prizren dhe mbrojtësit të akuzuarit e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren P.nr.1469/12 datë 30.11.2012, në seancën e kolegjit të mbajtur më 13.Qershor 2013, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat e Prokurorit Publik Komunal në Prizren dhe ajo e mbrojtësit të akuzuarit Z.F., avokatit N.Q, kurse aktgjykimi i Gjykatës së Komunale në Prizren P.nr.1469/12 datë 30.11.2012, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Gjykata Komunale në Prizren me aktgjykimin P.nr.1469/12 datë 30.11.2012, të akuzuarin Z.F., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë parashikuar me nenin 253 par.1 nënparagrafi 2 të KPK-ës, dhe për këtë vepër penale e ka gjykuar me dënim burgimi prej 8 (tetë) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej 20.09.2012 e gjerë më 30.11.2012. Është obliguar i akuzuari t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 100 €. Me të njëjtin aktgjykim gjykata të akuzuarin, në bazë të nenit 390 par.3, të KPPK e ka liruar

nga aktakuza për veprën penale Vjedhje e rëndë parashikuar me nenin 253 par.1 nënparagrafi 2 të KPK-ës/ pika II e aktakuzës/.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesa kanë ushtruar:

- Prokurori Publik Komunal në Prizren, përkitazi me pjesën liruese të aktgjykimit për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, vendimit për dënim për pjesën gjykuese, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet dhe apo të anulohet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

- mbrojtësi i të akuzuarit avokati N.Q nga Prizreni, për shkak të shkelje të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për sanksionin penal për pjesën gjykuese të aktgjykimit të ankimuar, me propozim që të anulohet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje ndërsa për pjesën liruese ka propozuar që aktgjykimi në fjalë të vërtetohet.

Për seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPP janë njoftuar Prokurori i Shtetit i Prokurorisë së Apelit, i akuzuari me mbrojtësin i tij dhe të dëmtuarat. Në seancë të kolegjit ishte i pranishëm mbrojtësi i të akuzuarit dhe i akuzuari ndërsa munguan Prokurori i Shtetit dhe të dëmtuarat edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt. Në seancë mbrojtësi i të akuzuarit av.N.Q nga Prizreni pasi sqaroi ca nga pretendimet e theksuara në ankesë ngeli pranë propozimeve të cekura në te meqrast propozoi që ankesë e Prokurorit të shtetit në të refuzohet si e pabazuar. I akuzuari Z.F. mbështeti në tërësi thëniet e mbrojtësit të tij.

Gjykata Apelit pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko- penale, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në ankesa, gjeti se:

- ankesat nuk janë të bazuara.

I. Edhe pse aktgjykimi i shkallës e shkallës së parë lidhur me pjesën liruese nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë, Gjykata Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPP dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike në ankesë nuk kontestohen faktet të cilat i ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë, por kontestohen vetëm konkludimet, mënyra si i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë provat e administruara, duke pretenduar se provat e administruara kanë paraqitur bazë të duhur që i akuzuari të shpallet fajtor për veprën e cila i është vënë në barrë. Kështu, sipas ankesës gjykata e shkallës së parë aktgjykimin lirues e mbështet vetëm në mbrojtjen e të akuzuarit kur mohon kryerjen e veprës penale në dëm të M.R. edhe pse kjo dëshmitare ka dëshmuar se i akuzuari disa herë ka qene

në shtëpinë e saj se i njëjti kishte njohuri se kjo me bashkëshortin poashtu të moshuar e të shurdhër jetojnë të vetmuar. Në vazhdim Prokurori pretendon në ankesë se mënyra e kryerjes së veprës penale me këputjen e zingjirit nga qafa e kësaj të dëmtuare është e njëjte me mënyrën e kryerjes së veprës penale për të cilën u shpall fajtor, andaj edhe i akuzuari duke pasur njohuri për të gjitha këto rrethana ai duke vu çorapë në fytyrë maskohet dhe ia merr stolin e arit duke ditur se e dëmtuara për shkak të moshës së shtyrë vështirë do të mund ta identifikonte. Theksohet se në praninë e këtyre provave, gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë e të plotë dhe i akuzuari është dashur që të shpallet fajtor për veprën penale për të cilën është liruar.

Gjykata Apelit vlerëson se pretendimet e mësipërme ankimore nuk qëndrojnë sepse:

Nga shkresat e çështjes, respektivisht aktgjykimi i kundërshtuar dalin si jokontestuese rrethanat se më 12.09.2012 rreth orës 17,00 në fshatin ... Komuna e Prizrenit, në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarës M.S. duke vepruar në mënyrë të posaçërisht të rrezikshme dhe të vrazhdë derisa e dëmtuara ndodhej në oborrin e shtëpisë familjare të saj, personi N.N. me çorapë në kokë ia këput zingjirin nga qafa e saj duke ia marrë të dëmtuarës ndërsa pjesa e zingjirit ngel te e dëmtuara. Këto rrethana nuk kontestohen nga e dëmtuara dëshmitare por në asnjë fazë të procedurës nuk ka mundur ta identifikoj kryesin e veprës penale pra edhe në shqyrtim gjyqësor nuk ka mundur ta identifikoj të akuzuarin si kryes të veprës penale ngase personi ka pasur të vendosur çorapë në kokë. Nga dëshmia e dëshmitarit S. S. poashtu nuk kontestohet se bashkëshortes së tij të dëmtuar M.S. i është vjedhur zingjiri nga qafa në mënyrën e përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar por nuk vërtetohet se ai personalisht ta ketë parë këtë person. Ndërsa nga dëshmia e dëshmitarit Fadil Bytyqi, gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar se ditën kritike kur vërtetohet se ndaj të dëmtuarës janë ndërmarr veprimet inkriminuese i akuzuari Z.F. nga ora 7,00 e gjerë në ora 19,00 ishte duke punuar si punëtor fizik në punët ndërtimore të firmës së tij në Prizren ku të akuzuarit i kishte siguruar edhe banim. Se i akuzuari ditën kritike ishte duke punuar me punëtorët tjerë në firmën e dëshmitarit B.F.e vërteton edhe dëshmitari B.M.po ashtu punëtor në këtë firmë.

Pra, gjendja e fakteve nuk është kontestuese, kontestuese ishte fakti se a ishte i akuzuari Z.F. ekzekutor i kësaj vepre penale, a mund të konkludohet se mënyra e njëjtë e kryerjes së veprës penale si në veprën penale për të cilën u shpall fajtor mjafton që i akuzuari të shpallet fajtor.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e prokurorit se mënyra e njëjtë e kryerjes së veprës penale si në veprën penale për të cilën u shpall fajtor vërteton faktin se i akuzuari ishte ekzekutor i kësaj vepre penale në dëm të M.R. janë vetëm supozim i prokurorit, sepse një gjë e tillë nuk është vërtetuar me prova bindëse e të sigurta. Pra, edhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate nuk është vërtetuar me pamëdyshje se i akuzuari ka kryer veprën penale. Me nenin 3 par.2 të KPP_është paraparë që mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen apo për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal sipas këtij kodi interpretohen në favor të pandehurit dhe të drejtave të tij. Kështu, bazuar në rrethanat e lartcekura ka vend që të aplikohet neni i lartcekur respektivisht instituti juridik “in dubio pro reo”, që do të thotë se konkludimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm.

II. Përkitazi me pjesën ndëshkuese, në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit pretendohet se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, një pjesë e konsideruar e aktgjykimit është arsyetuar në bazë të supozimeve të paarsyetuara dhe të paprovuara që e bëjnë tërësisht të pakuptueshëm, kundërthënës. Në ankesën e ushtruar të mbrojtësit nuk konkretizohet përveç që citohet dispozita e nenit 403 par. 1 pika 12 të KPPK, kurse arsyet e dhëna nga arsyetimi në këtë drejtim i referohen gjendjes faktike.

Gjykata Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet e mësipërme ankimore e as që aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje tjera esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kjo Gjykatë kujdeset detyrimisht, e të cilat kishin me kushtëzuar prishjen e tij.

Aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, parashikuar nga neni 403. par.1 nënp. 1.12.të KPP, të cilave ankesa u referohet pa bazë. Nuk ekzistojnë kurrfarë kundërthëniesh mes dispozitivit dhe arsyetimit. Në të vërtetë, gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar i ka paraqitur faktet që i ka vërtetuar dhe ka dhënë arsye të qarta logjike dhe bindëse përkitazi me rrjedhën e ngjarjes, të cilat, si të drejta, i aprovon edhe kjo Gjykatë, sepse gjykata e shkallës së parë ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 370 par.6 dhe 7.të KPP ka përshkruar rezultatin e procedurës provuese lidhur me faktet vendimtare dhe ka dhënë vlerësimin e duhur për provat e administruara, duke arsyetuar se përse disa fakte i mori si të provuara e disa jo, duke e vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit dhe pastaj ka arsyetuar qartë përse nuk e pranoi atë.

Në ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit përkitazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, në esencë mbrojtësi i të akuzuarit e konteston mënyrën se si janë vlerësuar provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjykatës së shkallës së parë si dhe konkludimet të cilat ka nxjerrë ajo gjykatë në bazë të provave. Pretendohet se provat janë vlerësuar në mënyrë të njëanshme dhe të gabuar dhe se konkludimet kanë pasuar të gabuara e që kanë pasur për pasojë edhe shkeljen e ligjit penal në dëm të akuzuarit. Pretendohet se gjendjen faktike gjykata e ka vërtetuar duke i dhënë besim vetëm dëshmisë së të dëmtuarës T.F të cilën mbrojtësi e konsideron si jokredibile dhe jo të besueshme ngase ajo e paraqet rastin në polici pas një muaji, se është e palogjikshme se në fshat të lehet dera e pambyllur me qelës. Sipas mbrojtësit e dëmtuara nuk ka arritur të sqaroj se si ka arritur ta identifikoj të akuzuarin si sulmues kur në dhomë ku ka ndodhur ngjarja nuk ka pasur ndriçim, ishte errësirë. Të gjitha këto mbrojtësi i konsideron si trillime sajime të dëmtuarës që të përfitoj nga i akuzuari të holla për ta tërhequr deklaratën akuzuese.

Gjykata e Apelit gjen se nuk qëndrojnë këto pretendime ankimore nga këto arsye:

Nuk janë kontestuese rrethanat se i akuzuari me nipin e të dëmtuarës ishin ditën kritike në shtëpinë e të dëmtuarës për t'ia uruar festën e Bajramit, se shtëpia ku jeton e dëmtuara me babain e saj të moshuar është faktikisht e përbërë prej një dhome e cila shërben edhe për

fjetje dhe se në këtë dhomë hyhet drejtë nga oborri. Nuk është kontestuese se një muaj pas vjedhjes e dëmtuara paraqet rastin në polici dhe se në dhomë kishte të vendosur një dritë nate. Dera hyrëse e dhomës nuk ishte e mbyllur me qelës.

Kontestuese ngelin rrethanat sipas pretendimeve ankimore të mbrojtësit se i akuzuari nuk është kryes i veprës penale.

Sipas shkresave të çështjes si dhe deponimit të dëmtuarës T.F i cili deponim përputhet me deponimet e saja të dhënë në të gjitha fazat e procedurës ku në mënyrë të detajuar e përshkruan zhvillimin e ngjarjes kritike e që vërtetohet se natën kritike rreth orës 03,00 derisa e njëjta ishte në gjumë duke fjetur në kauç në dhomën e vet i akuzuari përmes derës hyrëse të dhomës së pambyllur me çelës hyri brenda në dhomë dhe nga qafa e saj me qëllim vjedhje në mënyrë të rrezikshme dhe të vrazhdë duke ia mbyllë gojën me një dorë e me tjetrën ia tërheq dhe ia këput zingjirin nga qafa me q rast e dëmtuara zgjohet nga gjumi (gjatë tërheqjes së zingjirit) dhe në momentin kur i akuzuari me pjesën e këputur të zingjirit ishte duke ikë, dalë nga dera e dhomës njihet nga e dëmtuara e cila i thotë "...ti je o Z.o hajdut pse ma bëre këte..." ai largohet në drejtim të panjohur. E dëmtuara nuk paraqet rastin në polici por kur pas një kohe dëgjon se në fshat i ishte vjedhur zingjiri i fqinjës M.S vendos ta paraqes rastin në polici. E dëmtuara në dëshminë e saj deklaroi se kjo ngjarje ndodhë në mëngjesin e hershëm rreth orës 03,00, ku ende ishte tërë mirëpo në prizë ishte e vendosur një dritë nate dhe se kauçi ku flinte ishte i vendosur në pjesën e dhomë përballë derës hyrëse të dhomës.

Prandaj, në praninë e kësaj gjendje faktike dalin si të drejta dhe të ligjshme konkludimet e gjykatës së shkallës së parë se në veprimet inkriminuese të akuzuarit përmbushen tiparet e veprës penale, për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor dhe se drejtë është aplikuar ligji penal.

Prokurori Publik në ankesë lidhur me dënimin e shqiptuar të akuzuarit ka theksuar se nuk janë çmuar në mënyrë adekuate rrethanat rënduese gjatë matjes së dënimit, se personi i dëmtuar ishte e gjinisë femërore ishte duke fjetur në dhomën e vet e pambrojtur, rrethana këto që kishin për të arsyetuar shqiptimin e dënimit më të rënd. Në anën tjetër, mbrojtësi i të akuzuarit potencon se gjykata gabimisht ka vlerësuar si rrethanë rënduese elementin qenësor të veprës penale "... mënyrën posaçërisht të rrezikshme dhe të vrazhdë të kryerjes së veprës penale.." ndërsa nuk ka vlerësuar si rrethana lehtësuese në anën e të akuzuarit se është familjar, babë i dy fëmijëve, i gjendjes së varfër ekonomike, për herë të parë bie ndesh me ligjin.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Apelit ankesat e Prokurorit për një dënim më të rënd e të mbrojtësit për një dënim më të butë nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së sanksionit penal të akuzuarit, konform dispozitës së nenit 64 të Kodit Penal të aplikueshëm, i ka vlerësuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit.

Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin ka vlerësuar gjendjen familjare të akuzuarit, se më parë nuk ka qenë i gjykuar ndërsa si rrethanë rënduese ka marrë parasysh mënyrën posaçërisht të rrezikshme dhe të vrazhdë të kryerjes së veprës penale.

Rrethanat lehtësuese të vërtetuara dhe të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë i pranon edhe kjo Gjykatë me përjashtim të faktit se nuk mund të merret si rrethanë si rrethanë rënduese mënyrën e kryerjes së veprës penale sepse me të drejtë potencon mbrojtësi i të akuzuarit se rrethanat rënduese të cilat i ka vlerësua ajo gjykatë janë elementet qenësore të figurës së veprës penale për të cilën u shpall fajtor. Mirëpo sido që të jetë bazuar në rrethanat lehtësuese të cilat i pranon kjo Gjykatë si dhe duke pasur parasysh rrethanat e rastit konkret, del se dënimi të cilin ia ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë të akuzuarit është në përpjesëtim me intensitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, si ekzekutorë, dhe se duhet të jetë në shërbim të preventivës së përgjithshme, posaçërisht të asaj të posaçme (speciale), forcimit të moralit të shoqërisë, përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, në pajtim me kërkesat për siguri personale të popullatës dhe se me këtë dënim do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit, i parashikuar me dispozitat ligjore të Kodit Penal të aplikueshëm.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP u vendos si në dispozitivin të aktgjykimit.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.1730/2012, më 13.Qershor 2013

Procesmbajtësja,

Lirije Maksutaj

Kryetarja e kolegjit,

Mejreme Memaj

Anëtarët e kolegjit:

2. Fllanza Kadiu

3. Rasim Rasimi